

# PËRBALLJA ME COVID-19: TRENDI DHE NDIKIMET SOCIALE E EKONOMIKE

NËNTOR 2020





# **PËRBALLJA ME COVID-19: TRENDI DHE NDIKIMET SOCIALE E EKONOMIKE**

**NËNTOR 2020**

**Financuar nga:** Ky publikim është i financuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) dhe përgatitur nga Instituti për Hulumtime Zhvillimore Riinvest.

**Deklaratë mohimi:** Pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të mbështetësve.

**Autorë:**

Muhamet Mustafa

Pëllumb Çollaku

Tringa Shkodra, aneksi statistikor

Adnan Dema, aneksi statistikor

**Design:**

DROP

Originali është shkruar në shqip.

**Publikuar nga:**

RIINVEST INSTITUTE

Lidhja e Prizrenit nr. 42

10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

tel: + 381 (0)38 244320 |38 223816

e-mail: [riinvest@riinvestinstitute.org](mailto:riinvest@riinvestinstitute.org)

[www.riinvestinstitute.org](http://www.riinvestinstitute.org)

E drejta autoriale © 2020 nga INSTITUTI RIINVEST. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet në ndonjë sistem për ruajtje, apo të bartet, në çfarëdo forme apo me çfarëdo mjeti, qoftë mekanik, me fotokopje, incizim apo në mënyra të tjera, pa lejen paraprake me shkrim të botuesit.

# PËRMBAJTJA

## SHKURTESAT 6

## PASQYRË TABELARE E PËRGJITHSHME E TREGUESVE EKONOMIKË DHE SOCIALË PËR VLERËSIMIN BAZË DHE TË TRENDIT 7

### 1. HYRJE 8

### 2. KONTEKSTI GLOBAL DHE RAJONAL 10

### 3. TRENDI I PANDEMISË DHE SISTEMI SHËNDETËSOR 12

### 4. RËNIA E AKTIVITETIT EKONOMIK – RECESIONI 18

### 5. PËRGJIGJET E QEVERISË – INTERVENIMET QEVERTARE 22

#### 5.1. BUXHETI DHE SFIDAT E REALIZIMIT TË TIJ 22

#### 5.2. PROGRAMI I RIMËKËMBJES DHE PENGESAT LIGJORE 24

### 6. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME 27

## ANEKSI 1: TE DHENAT MBI PRODUKTIN VENDOR BRUTO NE TREMUJORIN E DYTE 29

## ANEKSI 2: TE DHENAT PER TREGTINE JASHTME – EKSPORTI DHE IMPORTI I MALLRAVE NE TREMUJOIN E DYTE DHE TRETE 2020 30

## ANEKSI 3: VLERËRSIMET NGA INTERVISTA E UDHËHEQËSVE TË BIZNESVE PRIVATE MBI ECURINË E SHITJEVE 32

## ANEKSI 4: PASQYRA E MASAVE NGA PROGRAMI I RIMËKËMBJES DHE REALIZIMI I TYRE 33

## ANEKSI 5: PASQYRA E MOBILIZIMIT TË BURIMEVE FINANCIARE PËR PROGRAMIN E RIMËKËMBJES 347

## REFERENCAT 35

# SHKURTESAT

**ASK** → Agjencia e Statistikave të Kosovës

---

**BB** → Banka Botërore

---

**BQK** → Banka Qendrore e Kosovës

---

**FMN** → Fondi Monetar Ndërkombëtar

---

**PVB (GDP)** → Produkti Vendor Bruto (Gorss Domestic Product)

---

**MF** → Ministria e Financave

---

## PASQYRË TABELARE E PËRGJITHSHME E TREGUESVE EKONOMIKË DHE SOCIALE PËR VLERËSIMIN BAZË DHE TË TRENDIT

	2019	2020	Ndryshimi në %	Trendi
1 Prodhimi i Brendshëm Bruto, TM2, mil. Euro	1,790	1,654	- 8	↓
2 Eksporti TM2+TM3, mil. Euro	212	235	+ 11	↑
3 Importi Tm1+TM2, mil. Euro	1,836	1,580	-14	↓
4 Remitenat, janar-gusht, mil. Euro	522	711	+36	↑
5 Norma e papunësisë	26.5 %	25.0 %		↓
6 Inflacioni	2.6	0.6		↓
7 Investimet/Formimi i kapitalit bruto, TM2, mil. Euro	626	374	-40	↓
(a) Investimet e jashtme TM1+TM2	110	164	+49	↑
8 Depozitat , gjendja , gusht , mil euro	3,400	3,900	+ 14,7	↑
Kreditë, gjendja, gusht, mil. Euro	2,900	3,100	+6.9	↑
(a) Kreditë e reja, mil. Euro	711	694	-3.4	↓
(b) Interesi ne kredi %	6.44	6.26	-2.8	↓
10 Bizneset e reja te regjistruara ( numri) TM2+TM3	5,034	4,626	-9	↓
11 Të ardhurat buxhetore, janar- shtator, mil. Euro	1,236	1,085	-12.2	↓
12 Shpenzimet buxhetore , janar –shtator, mil. Euro	1,365	1,440	+5.5	↑
(a) Shpenzimet qeveritare në shëndetësi buxheti	226	237	+4,9	↑
13 Transferet qeveritare (bizneset)				
Borxhi publik dhjetor/ shtator, mil. Euro	1,201	1,342	+11.6	↑
(a) Borxhi i brendshëm	792	934	+17.9	↑
(b) Borxhi i jashtëm	409	407	-0.5	↓
15 Familjet në ndihmë sociale	24,526	24,496	-0.1	↓
16 Konsumi i energjisë (industria) MW TM2	98,6	86,2	-13.6	↓
17 COVID numri mesatar i rasteve aktive	-	3,444	-	↓

### Sqarime:

TM – Tremujori përkatës

Burimet e të dhënave janë dhënë në tekstin e raportit

# 1. HYRJE

Ky Raport është përgatitur që të shërbejë si një vlerësim inicial-bazik, paraprijës për një sërë vlerësimesh periodike në vazhdim lidhur me situatën e krijuar me përhapjen e pandemisë COVID-19 si dhe të përgjigjeve institucionale dhe akterëve tjerë ndaj kësaj situatë. Ka për qëllim vlerësimin e kushteve në të cilat po zbatohet Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike të aprovuar nga Qeveria, efektivitetin në zbatimin e tij dhe trendët ekonomikë socialë të ndërlidhur me të. Synohet një vlerësimin sistematik i fushave kryesore dhe fazave të zbatimit programit, një vlerësim i cili mundëson matjen-vlerësimin e rezultateve për të iniciuar angazhimet institucionale dhe të tjera për përmirësimet e nevojshme në realizim e sipër të këtij programi. Qëllimi kryesor i Raportit është të rritet efektiviteti në nivelin makro dhe atë të përfituesve, dhe t'i shërbejë Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, ministrive, agjencive tjera qeveritare, dhe palëve tjera të interesuara në mënyrë që informimi rreth vendimmarrjes mbi programin e rimëkëmbjes të jetë i mirë, i bazuar në evidencë, duke i kontribuar rritjes së përgjegjësisë dhe transparencës në aktivitete dhe masat që merren në tejkalimin e pasojave mjaft të rënda të COVID-19 lidhur me situatën shëndetësore, sociale dhe ekonomike.

Raporti ka për qëllim edhe të iniciojë një debat të angazhuar, konstruktiv dhe vetëdijesues në shoqëri. Përderisa debati në shoqëri lidhur me pasojat ekonomike e sociale të COVID-19 është intensifikuar, ai nuk duket të jetë i bazuar në hulumtime të paanshme duke qenë i ngarkuar nga këndvështrimet e veçanta sektoriale ose interesave parciais e politike. Një debat joproduktiv kemi mundur ta shohim edhe në seancat e fundit të Kuvendit të Kosovës dhe atë në të tri boshtet – (1) trendët e infektiveve dhe shkaqet e rritjes së tyre, (2) shtyrja e aprovimit të rishikimit të buxhetit për 2020–ën, shtyrja e aprovimit të Ligjit për rimëkëmbje si dhe shtyrja e ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare që kanë efekte të kompletimi i burimeve të financimit dhe (3) konflikti i ashpër politik që ka

ngushtuar horizontin e mendimit të arsyeshëm e të përgjegjshëm.

Vlerësimi përqendrohet në aspektet strategjike dhe përparësitë e zbatimit të programit me theks në identifikimin e përfitimeve të mundshme dhe interesave publike, rezultatet e programit, supozimet dhe rreziqet. Përveç analizës përmes treguesve shëndetësorë të pandemisë dhe trendëve ekonomikë, Raporti trajton po ashtu edhe përgjegjësinë e institucioneve të mandatuara për veprim në këtë kohë krize, duke analizuar masat që po merren dhe ato që mungojnë. Nëpërmjet hulumtimit, raporteve, analizës së Programit të Rimëkëmbjes, dhe analizës së këndshikimeve të akterëve të ndryshëm, e veçmas komunitetit të biznesit, analizës së përvojave nga vendet e tjera, dhe sektorëve të caktuar të ekonomisë, ky Raport, përmes rekomandimeve të tij synon të shtojë vlerë në politikëbërjen ekzistuese dhe do të kontribuojë që të kuptohet dimensionin real në planin shëndetësor, ekonomik e social.

Përhapja e Coronavirusit (COVID-19) gjatë fillimit të muajve të parë të vitit 2020 pothuajse në të gjithë botën ka thyer parashikimet për ndikimet negative për trendët ekonomikë dhe thellësinë e recesionit thuaja në mbarë botën, përfshi rajonin e Ballkanit Perëndimor. Në parashikimet e tilla nuk përjashtohet as Kosova, si një ekonomi e vogël e hapur dhe e varur nga ekonomitë e tjera më të mëdha, sidomos me ato të BE-së. Sëmundja pandemike COVID-19 po vazhdon me trajektoren e saj ngritëse, tashmë duke hyrë në valën e saj të dytë edhe në Kosovë. Ky realitet i ri përbën një sfidë të madhe për qeveritë e të gjitha shteteve anembanë globit.

Raporti bazohet në analizën e të dhënave të publikuara statistikore nga ASK, Banka Qendrore, Ministria e Financave si dhe raporteve dhe analizave të tjera në vend dhe jashtë. Përqendrimi është te zhvillimet në tremujorin e dytë dhe pjesërisht, varësisht nga të dhënat në dispozicion, edhe në atë të tretë të vitit 2020, dhe në krahasimin e zhvillimeve me tremujorët paraprak dhe vitin 2019. Aty ku ka pasur



të dhëna janë përfshi edhe zhvillime në tremujorin IV. Disa informacione të vlefshme janë marrë edhe nga Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, Ministria e Shëndetësisë dhe ajo e Bujqësisë. Instituti Riinvest falënderon ministrat, përkatësisht zëvendësministrat e këtyre dikasterëve për bashkëpunimin e tyre. Gjithashtu, Raporti bazohet edhe në vlerësimet e 35 udhëheqësve të bizneseve nga sektorë të ndryshëm, të cilët janë intervistuar në korrik dhe tetor të këtij viti. Raporti në aspektin metodologjik synon që të ndërtojë një bazë për vlerësime të mëtejme periodike, tremujore, duke ndërtuar një sistem monitorimi me tregues që pasqyrojnë rrjedhat dhe progresin në mbizotërimin e pandemisë dhe tejkalimin e pasojave të saj ekonomike e sociale.

Përveç hyrjes, Raporti në fillim adreson kontekstin global dhe rajonal, pastaj analizon trendët e

përhapjes së COVID në periudha të ndryshme si dhe problemin e financimit të pamjaftueshëm të shëndetësisë publike në Kosovë. Në kapitullin vijues trajtohen trendët ekonomike dhe përmasat e recesionit ekonomik në Kosovë. Në vazhdim jepet një vështrim mbi aktivitetet dhe politikat qeveritare për t'iu përgjigjur situatës së ndikuar nga pandemia dhe lidhur me këtë edhe problemet buxhetore si dhe problemet me të cilat po përballet zbatimi i Programit qeveritar të Rimëkëmbjes. Raporti përmbyllet me përfundime dhe rekomandime.

Përgatitja e këtij Raporti dhe aktivitetet e tjera lidhur me këtë Raport janë mbështetur nga KFOS (Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur). Instituti Riinvest e falënderon KFOS për bashkëpunim domethënës. Instituti Riinvest merr përgjegjësinë për konstatimet dhe rekomandimet e dhëna në këtë Raport.

## 2. KONTEKSTI GLOBAL DHE RAJONAL

Me gjithë masat e marra në planin global dhe atë nacional mbizotërimi i pandemisë COVID-19 nuk duket ende në horizont. Për më tepër, duke filluar nga gjysma e dytë e tetorit ajo që po quhet "vala e dytë" ka ngritur dukshëm ritmin e infektiveve të reja. Në fund të tetorit, krahasuar me dy javët para-prake numri i infektiveve në planin global ka pësuar ngritje të shpejtë. Nga 210 vende të përfshira në Evidencën e ECDC, 133 kanë pasur rritje të numrit, prej të cilave 39 më tepër se dyfish<sup>1</sup>. Vetëm te 55 vende kishte zvogëlim të numrit të rasteve të reja, kurse vetëm 6 vende nuk kanë evidentuar fare raste të reja. Sipas këtij raporti midis vendeve me ritmin më të përshpejtuar të infektiveve gjenden pikërisht disa vende evropiane<sup>2</sup>. Duket se të gjitha vendet tanimë e kanë të qartë se duhet të krijojnë parakushtet që të "bashkëjetohet me COVID-19"<sup>3</sup> dhe kjo nënkupton që institucionet e shëndetit publik duhet të jenë në gjendje të përballojnë rrjedhën e infektiveve dhe që mbi këtë bazë të evitohet nevoja për mbyllje radikale çfarë e kishin aplikuar një numër i konsiderueshëm i vendeve evropiane, pasi që kjo do të kishte pasoja të rënda në reduktimin e aktiviteteve ekonomike e sociale, të papërbalueshme në aspektin fiskal dhe social. Përgjigjja e menjëhershme me një arsenal masash të llojllojshme mbështetëse për të përballuar tkurrjen e madhe ekonomike, ka dhënë rezultate por jo në nivelin e pritur. Masat ishin të përqendruara te një mbështetje e bizneseve dhe ekonomive familjare, e sidomos për ruajtje të vendeve të punës, por është evidente se tkurrja e aktivitetit ekonomik e shprehur me GDP është dukshëm më e madhe, kështu që pritet për

një këndellje janë spostuar për pjesën e dytë të vitit të ardhshëm. Në vlerësimet e FMN-së që datojnë nga 20 tetori i këtij viti, vlerësohet se masat restriktive sa i përket distancimit social dhe çrregullimet në zinxhirët e furnizimit kanë ndikuar në një rënie të madhe të paprecedent (kolaps) të GDP-së në kuartalin II të këtij viti në krahasim me 2019 dhe atë për rreth 40% dhe e tërë kjo parashikohet se do të ndikojnë në një tkurrje të GDP-së në Evropë për rreth 7% në krahasim me vitin paraprak, për dallim nga projeksionet në qershor (4.9%). Ndërkaq parashikimet ballafaqohen me një pasiguri dhe rreziqe<sup>4</sup>. Sfida kryesore me të cilën ballafaqohen qeveritë, përkatësisht projektuesit dhe zbatuesit e politikave, do të jetë se si të bëjnë një kalibrim të masave për t'i minimizuar dëmet ekonomike dhe sociale. Sugjerohet që mbështetja e bizneseve për t'i mbajtur aktive vendet e mira të punës është e domosdoshme dhe se një tërheqje e parakohshme nga këto programe do ta thellonte recesionin.

Banka Botërore në Raportin e saj vjeshtor për situatën ekonomike në rajonin e Ballkanit Perëndimor<sup>5</sup> konstaton se pandemia ka shkaktuar një recesion të thellë në vendet e Ballkanit Perëndimor, i shkaktuar nga të dyja anët, rënia e kërkesës dhe çrregullimi i zinxhirëve të furnizimit si pasojë e masave shtrënguese të lëvizjes. Midis vendeve të Ballkanit Perëndimor ka gjithkund një tkurrje të GDP-së në krahasim me 2019, por më së shumti janë goditur Mali i Zi me një rënie të GDP-së (-12.4%, Kosova (-8.8%) dhe Shqipëria (-8.4%) për dallim nga Serbia, Bosnjë e Hercegovina dhe Maqedonia Perëndimore, ku kjo

1 European Centre for Disease Prevention and Control (ECDC), 30 tetor 2020

2 Më tepër se një dyfishim të rasteve të reja të infektiveve, në krahasim me dy javët para-prake ka pasur në këto vende evropiane: Austria, Bosnia and Herzegovina, Bulgaria, Croatia, Czech Republic, France, Germany, Greece, Guernsey, Italy, Kosovo, Liechtenstein, Lithuania, Luxembourg, Monaco, Poland, Portugal, San Marino, Serbia, Slovakia, Slovenia, Switzerland; Njëzet vende të tjera evropiane kishin rritje të numrit të infektiveve, e vetëm në 6 prej tyre zvogëlim (Finland, Vatican, Iceland, Isle of Man, Moldova, Montenegro), ECDC, 30 tetor 2020.

3 Bashkëjetesa me Covid -19: Instituti Riinvest (korrik 2020)

4 FMN: Regional Outlook Europe, tetor 2020

5 BB: Un Uncertain Recovery, Fall 2020

rënie ishte 3-4%. Shkaku i një rënie kaq të thellë në tri vendet e përmendura është kryesisht te turizmi, i cili në rastin e Kosovës ka të bëjë thuaja krejtësisht me të ashtuquajturin “Turizmi i Diasporës”.

Konteksti i përgjithshëm përderisa po shkruhet ky raport rëndohet me një shpërthim të infektiveve të reja kudo në rajon por edhe në Kosovë duke u arritur një “rekord” prej 546 infektimesh të reja me COVID-19 (4 nëntor 2020) dhe 661 raste të reja (5 nëntor), pas një vale infektimesh gjatë javës që

mesatarisht silleshin rreth 420 raste të reja brenda ditës. Kjo vë në sprovë serioze edhe njëherë kapacitetet e institucioneve publike shëndetësore, por dhe përgjithësisht kapaciteteve institucionale për ta menaxhuar këtë situatë. E tërë kjo në një kohë kur situata politike mbetet e brishtë dhe aftësia e mobilitetit institucional gjithashtu fragjil dhe i kërcënuar seriozisht edhe nga lufta e brendshme politike dhe pasojat në gjithë këtë të akuzave nga Gjykata Speciale.

# 3. TRENDI I PANDEMISË DHE SISTEMI SHËNDETËSOR

Kosova gjendet në një fazë delikate të përballjes me pandeminë. Kemi hyrë në atë që quhet si ‘vala e dytë’ e kësaj epidemia, e paralajmëruar edhe si më përhapëse, ndonëse duket se karakterizohet me

më pak viktima në raport me numrin e rritur të të infektuarve. Ritmi i infektiveve me COVID-19 në Kosovë karakterizohet me disa fazat që pasqyrohen në tabelën 1.

**TABELA 1. TRENDI I INFEKTIVEVE ME COVID -19**

**Vlerat mesatare ditore**

Periudha	Testimet	Infektimet	Rastet aktive (mesatarja e periudhës)	Numri i vdekjeve
13 mars- 30 qershor	215	26	366	0.5
1 korrik- 14 tetor	505	129	2622	6
15 tetor- 8 nëntor	1248	332	3444	5

**BURIMI:** INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË PUBLIKE TË KOSOVËS

Karakteristikat e këtij trendi mund të përmblihen me sa vijon :

(1) Faza parë (13 mars – 30 qershor), kontrolli i rreptë me masa shtrënguese, me numër relativisht të vogël të të infektuarve dhe rasteve fatale, por edhe numër të vogël testimesh dhe reduktim drastik të aktiviteteve ekonomike e sociale, sidomos deri kah mesi i majit, të përcjellë me masa modeste të intervenimeve qeveritare për t’i përballuar pasojat; një fazë që mund të karakterizohet si faza “mbyllur, ruajtur dhe prit”. Efekti nga shtrëngesat dhe mbyllja nuk u dukën esenciale në fazat e mëtejme, pasi që masat nuk ishin selektive dhe efektive dhe nuk u përcollën me aftësim domethënës të institucioneve të shëndetit publik për të përballuar me sukses incidencën e lartë e eksplozive të infektiveve që duhej patjetër të parashikohej pas hapjes.

(2) Faza e dytë: Hapja totale dhe joselektive (30 qershor – 15 tetor 2020) e deklaruar nga Qeveria e shkarkuar, në ditët e lëshimit të zyrave nga ana e saj. Qeveria e re u ballafaqua një situatë që do të sillte domosdo rritje të infektiveve. Qeveria u angazhua duke rritur kapacitetet e testeve dyfish në fillim, e më vonë edhe trefish, herë më shumë, por edhe me një situatë të moszbatimit rigoroz të masave dhe rekomandimeve të IK-SHP-së dhe Ministrisë së Shëndetësisë, dhe kjo solli rritje të dukshme të infektiveve dhe rasteve fatale në periudhën qershor - korrik; Kjo u pasua me një ngadalësim në periudhën korrik – gusht, e sidomos në shtator dhe deri në fillim të tetorit, kur përsëri fillon rritja e frekuencës ditore të numrit të të infektuarve; Aktivitetet ekonomike u ringjallën por në suaza më të vogla sesa pritej, kryesisht për shkak të vonesës në aprovimin e rishikimit të Buxhetit për vitin 2020 dhe pamundësisë së aprovimit të Ligjit që mbështet Programin qeveritar të Rimëkëmbjes.

(3) Faza e tretë (15 tetor dhe në vazhdim): Vala e dytë e COVID-19 e cila në disa vende fqinje dhe evropiane filloi më herët dhe e cila po shpërfaqet me dyfishime më tepër të numrit të të infektuarve, me kërcënim serioz për të imponuar masa shtrënguese në sektorë të caktuar e që do të ndikonin negativisht në aktivitete ekonomike e sociale të shoqëruar me vështirësi për të aprovuar dhe zbatuar masat nga Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike. Java e dytë e nëntorit solli rekordin e numrit ditor të infektimeve, mbi 800, dhe kjo po e vë në sprovë seriozisht mundësinë e institucioneve publike shëndetësore që të trajtojnë në mënyrë adekuate fluksin e pacientëve që kërkojnë trajtim.

Kosova sikurse edhe shtetet e tjera të rajonit, duke ditur brishtësinë e sistemeve të tyre shëndetësore, gjatë valës së parë të infektimeve ka reaguar me shpejtësi në vendosjen e masave drakonike në kufizimin e lëvizjes, distancës sociale e fizike, dhe aktiviteteve ekonomike, por situata i doli nga duart gjatë lehtësimit të masave. Edhe pse gjatë muajit shtator në Kosovë situata u përmirësua, vala e dytë e infektimeve mund të prodhojë efekte të padëshirueshme nëse sensibilizimi i popullatës nuk do jetë në nivelin e duhur pasi që qeveria dhe masat e saj drastike nuk janë të mjaftueshme pa rritjen e vetëdijes qytetare.

**TABELA 2. INDIKATORËT E PANDEMISË COVID-19 NË SHTETET E BALLKANIT PERËNDIMOR (BP), DHE POPULLSIA, NË VLERA NOMINALE**


Shteti	Raste aktive COVID-19	Nr. i vdekjeve nga COVID-19	Nr. i testeve për COVID-19	Nr. i popullsisë
BeH	7,807	981	274,453	3,282,698
Kosova	1,577	653	80,096	1,775,400
Mali i Zi	4,530	231	79,972	628,058
Maqedonia V.	5,266	824	219,158	2,083,382
Serbia	3,636	774	1,232,793	6,982,600
Shqipëria	6,325	448	106,093	2,878,095

**BURIMI:** TË DHËNAT PËR RASTET COVID-19 JANË MARRË NGA INSTITUTET KOMBËTARE TË SHËNDETËSISË PUBLIKE TË VENDEVE PËRKATËSE. NUMRAT KORRESPONDOJNË, ME DATËN 17 TETOR, 2020; TË DHËNAT E POPULLSISË JANË NGA BANKA BOTËRORE, EUROSTAT, ZYRAT KOMBËTARE TË STATISTIKAVE DHE BANKA QENDRORE E KOSOVËS.

Situata aktuale (deri më datën 17 tetor 2020) në Kosovë dhe rajon portretizohet në Tabelën 1, në të cilën Kosova del të jetë vendi me më së paku raste aktive në rajon ku prin Bosnjë e Hercegovina, e katërta për nga numri i vdekjeve (prin BeH), dhe e parafundit për nga numri i testeve (prin dukshëm Serbia).

Figura 1 e cila si një vlerë krahasuese jep edhe mesataren e numrit të të infektuarve në raport me popullsinë, jep një pasqyrë më të qartë rreth këtij proporcioni, duke renditur Kosovën të parafundit sa i përket numrit të infektimeve, në raport me popullsinë. Ky rezultat gjithsesi i volitshëm duhet të interpretohet me rezervë sa i përket numrit faktik të infektimeve kur të kemi parasysh numrin e testeve.

**FIGURA 1. NUMRI I INFKTIMEVE NË RAPORT ME NUMRIN E PËRGJITHSHËM TË POPULLSISË NË KOSOVË DHE RAJON, I SHPREHUR NË PËRQINDJE, PERIUDHA 13 MARS – 8 KORRIK, 2020**



**BURIMI:** TË DHËNAT PËR RASTET COVID-19 JANË MARRË NGA INSTITUTET KOMBËTARE TË SHËNDETËSISË PUBLIKE TË VENDEVE PËRKATËSE. NUMRAT KORRESPONDOJNË ME DATËN 17 TETOR, 2020; TË DHËNAT E POPULLSISË JANË NGA BANKA BOTËRORE, EUROSTAT, ZYRAT KOMBËTARE TË STATISTIKAVE DHE BANKA QENDRORE E KOSOVËS.

Nëse treguesit nga Tabela 1 i vendosim në proporcion me popullsinë, mund të nxjerrim koeficient relevant për të kuptuar rezultatin e masave të marra nga qeveritë e rajonit, dhe mund të shpalojmë më shumë informacion. Ky rezultat paraqitet në Tabelën 2, shifrat e së cilës korrespondojnë me të dhënat deri më 17 tetor 2020. Shihet qartë që Kosova për nga numri i testeve në raport me popullsinë qëndron e parafundit në rajon me 4.51% të popullatës të testuar (më së keqi është vetëm Shqipëria si e fundit me 3.69%). Raste aktive në raport me popullsinë më së shumti paraqitet të ketë Mali i Zi, 0.72% të popullsisë, derisa Kosova renditet në vendin e dytë me më së paku raste aktive, 0.09%, menjëherë pas Serbisë me 0.05%. Por Kosova qëndron më së keqi në rajon me një tregues tjetër, kur kemi parasysh se 3.87% të rasteve të infektuara që

përfundojnë në fatalitet nga COVID-19. Kjo është një gjetje alarmante duke pasur parasysh edhe strukturën e favorshme moshore të popullsisë. Kjo gjetje mund të jetë si rezultat i shumë faktorëve. Studime më të detajizuara në të ardhmen mund të nxjerrin rezultatet e sakta, por disa nga më të besueshmet mund të jenë që shifrat shpërfaqin qartazi deficitet në kapacitetet shëndetësore në Kosovë, shërbimet mjekësore dhe testimet e pakta dhe të vonuara. Këto të fundit reflektohen edhe në përqindjen e infektiveve në raport me numrin e testeve ku 21.09% e të testuarve dalin pozitiv me COVID-19, që është një shifër shumëfish më e lartë sesa ajo e Serbisë (2.92%). Përqindja e lartë e të testuarve pozitiv me virusin Corona lë të kuptojë për një kontroll të vogël të shpërndarjes së virusit në të gjithë popullsinë e vendit.

**TABELA 2. INDIKATORË KRAHASUES TË TRENDIT TË PANDEMISË COVID-19 NË SHTETET E BALLKANIT PERËNDIMOR, NË PËRQINDJE**

Shteti	Numri i testeve/ Nr. i popullsisë	Rastet aktive/Nr. i popullsisë	Nr. i vdekjeve/nr. i infektiveve	Nr. i infektiveve/ Nr. i testeve
BeH	8.36	0.24	2.92	12.23
Kosova	4.51	0.09	3.87	21.09
Mali i Zi	12.73	0.72	1.49	19.42
Maqedonia V.	10.52	0.25	3.55	10.59
Serbia	17.66	0.05	2.15	2.92
Shqipëria	3.69	0.22	2.67	15.81

**BURIMI:** TË DHËNAT PËR RASTET COVID-19 JANË NGA INSTITUTET KOMBËTARE TË SHËNDETËSISË PUBLIKE TË VENDEVE PËRKATËSE, DATA E FUNDIT 17 TETOR, 2020. TË DHËNAT E POPULLSISË NGA BANKA BOTËRORE, EUROSTAT, ZYRAT KOMBËTARE TË STATISTIKAVE DHE BANKA QENDRORE E KOSOVËS. KALKULIMET JANË TË AUTORËVE.

Edhe më tej, shifrat tregojnë që gjendja e sistemit shëndetësor dhe aftësia e tij që të përballojë një krizë të shëndetit publik gjatë valës së dytë të infektiveve duhet të jetë sfida kryesore për Qeverinë. Dobësimi i sistemit shëndetësor dhe eksodi masiv i stafit mjekësor nga Kosova dhe Ballkani Perëndimor drejt BE-së janë dy arsye që kanë zbehur mundësitë

e një reagimi të shpejtë dhe për të zbutur gjendjen gjatë pandemisë. Derisa kualiteti i dobët i sistemit publik shëndetësor varet nga pasuria dhe stadi i zhvillimit ekonomik, rrjedhimisht, shtetet më të pasura pritet të jenë më të suksesshme në tejkalimin më të shpejtë të situatës, gjë që nuk është rasti me Kosovën.

**TABELA 4. SHPENZIMET QEVERTARE TË KOSOVËS NË SHËNDETËSI 2018 – 2020, NË MILIONË EUR<sup>6</sup>**

	2018	2019	2020 (rishikimi)
Shpenzimet qeveritare në shëndetësi	197	226	237
Produkti Vendor Bruto	6,641	7,123	6,961
Shpenzimet/PVB	2.9%	3,1	3.4

BURIMI: DREJTORIA E BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE.

Ashtu siç ilustron edhe Tabela 3, shpenzimet qeveritare në shëndetësi - të cilat përfshijnë gjithë intervenimet në nivelin primar, sekondar, terciar e administrativ, tregon për një nivel tepër të ulët të financimit të shëndetësisë nga burimet buxhetore në Kosovë. Ndonëse me një tendencë përmirësimi (nga 2.9% të GDP-së më 2018, në 3.4% me buxhetin e rishikuar për vitin 2020), situata mbetet emergjente dhe gjithnjë Kosova mbetet shumë prapa nevojave e mund të thuhet edhe domosdoshmërisë për ta përmirësuar gjendjen kritike në këtë sektor.

Deklarimet e thuaja të gjitha kabineteve qeveritare për t'i dhënë një prioritet këtij sektori kanë mbetur vetëm në një nivel verbal. Kjo shihet edhe më mirë në tabelën e mëposhtme nëse krahasohemi me vendet e rajonit e të mos flasim për standardet evropiane. Edhe pse krahasimi me vitet mund të mos përputhet si pasojë e mungesës së të dhënave krahasuese për të gjitha vendet në të gjitha vitet,

prapëseprapë, për një ose dy vjet të ketë dallime të tilla që janë shqetësuese.

Kosova shpenzon rreth 3 herë më pak në këtë sektor krahasuar me Bosnjë e Hercegovinën dhe Serbinë që prijnë në rajon, dhe gati dy herë e gjysmë më pak sesa Mali i Zi, dhe dyfish më pak sesa Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut krahasuar me fuqinë ekonomike (shpenzimet në raport me GDP-në). Përmirësimet të cilat janë bërë deri sot, edhe përgjatë situatës pandemike nuk janë të mjaftueshme në këtë situatë, Ato janë me tepër intervenime te ngutshme dhe nënpresion, te pamjaftueshme në një afat të gjatë, për ta kompensuar prapangeljen serioze me investimet në të kaluarën dhe atë si në infrastrukturë fizike, teknologjike e administrativp menaxheriale, e po ashtu edhe në adresimin e rrjedhjes së kapitalit human. Ndonëse shihet një hap pozitiv me buxhetin e rishikuar kjo duket krejtësisht e pamjaftueshme për të bërë një përmirësim të ndjeshëm të gjendjes në gjithë nivelet e kujdesit shëndetësor.

<sup>6</sup> Instituti RIINVEST: Bashkëjetesa me Covid-19, tri shtylla të rimëkëmbjes (korrik 2020)



**TABELA 5. INDIKATORË TË SHËNDETIT PUBLIK NË KOSOVË DHE RAJON, NË PËRQINDJE.**

Viti	Popullata mbi 65 vjeç, % e totalit	Shpenzimet qeveritare në shëndetësi, % e BPV*	Shpenzimet qeveritare në shëndetësi, US\$ per capita*
	2020 (vlerësim)	2017	2017
BeH	17.9	9.2	443.8
Kosova	6.3	3.1	126.17
Mali i Zi	15.8	7.6	531.7
Maqedonia V.	14.5	6.3	327.8
Serbia	19.1	9.1	494.4
Shqipëria	14.7	6.7	271.5

**BURIMI:** TË DHËNAT PËR POPULLSINË MBI 65 VJEÇ JANË VLERËSIME PËR VITIN 2020 NGA BANKA BOTËRORE DHE EUROSTAT, PËR KOSOVËN NGA AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS, VITI 2018. TË DHËNAT MBI SHPENZIMET QEVERTARE NË SHËNDETËSI NGA OBSH, BANKA BOTËRORE, WIIW DHE MF TË KOSOVËS; \*KOSOVA 2019.

Sipas të dhënave dhe raportit për shpenzime nga Departamenti për Politika Makroekonomike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar në Ministrinë e Financave të Republikës së Kosovës (Tetor, 2020) nuk del që Qeveria ka bërë ndonjë intervenim substancial në shtyllat kryesore të lartpërmendura në sistemin shëndetësor të vendit. Në rritjen e shpenzimeve të buxhetit thuhet që kryesisht kanë kontribuar pagat dhe mëditjet për pagesat shtesë dhe bonuset për personelin shëndetësor dhe policinë, e jo intervenime të domosdoshme në ngritjen e kapaciteteve shëndetësore. Disa hapa në punësimin e mjekëve specialistë, rifillimin e specializimeve, rritjen e kapaciteteve për testime janë hapa në drejtimin e duhur por duhet të shoqërohen me rritje të buxhetit që kapacitetet e pajisjeve dhe

kapacitetet humane të këtij sektori të sillen së paku në nivel të rajonit. Kjo mund të shihet edhe nga Korniza e shpenzimeve afatmesme 2020- 2022<sup>7</sup>, ku përkunder rritjes së shpenzimeve qeveritare në shëndetësi gjatë këtij viti, për rreth 30% në krahasim me vitin paraprak, nga ky dokument nuk duket një synim i qëndrueshëm për ta tejkaluar financimin e pamjaftueshëm në këtë sektor, ngase buxheti i parashikuar për dy vitet vijuese parashihet të zvogëlohet në vitin 2021 për rreth 18% e në vitin 2022 edhe më shumë<sup>8</sup>. Andaj ka nevojë për një rishikim serioz rreth këtij sektori në aspektin strategjik në mënyrë që me politika qeveritare dhe buxhetore të arrihen ndryshimet e domosdoshme për tu përfaruar me standardet e nevojshme së paku me ato të nivelit rajonal.

<sup>7</sup> MF : Korniza e Shpenzimeve Afatmesme 2020-2022, shtator 2020

<sup>8</sup> Gjatë këtij viti ka pasur një intervenim më të shprehur nga donatorët me grante si dhe me një numër të konsiderueshëm të shtretërve, barërave dhe testeve falas.

# 4. RËNIA E AKTIVITETIT EKONOMIK – RECESIONI

Rënia e aktivitetit ekonomik nën ndikimin e masave shtrënguese dhe pasojave shëndetësore nga infektimet po paraqitet një dukuri globale, ndaj e ka goditur edhe Kosovën. Nga një rritje e parashikuar ekonomike për vitin 2020 prej 4.7 %<sup>9</sup>, Qeveria e Kosovës në kuadër të vlerësimeve të nevojshme për rishikimin e Buxhetit të 2020-s dhe për aprovimin e Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike të ndërlidhur me efektet e COVID-19, reduktoi parashikimet e rritjes ekonomike në përmasat e një tkurrjeje të Produktit Vendor Bruto (GDP) prej 3%. Që atëherë ky fakt u konsiderua si një version optimist në krahasim me vlerësimet e FMN-së dhe gjithashtu vlerësimet tona që parashihnin tkurrje rreth 5%. Ndonëse ende flasim për vlerësime paraprake dhe parashikime<sup>10</sup>, rënia e aktivitetit ekonomik duket se do të jetë dukshëm më e shprehur. Të dhënat zyrtare me vlerësimet e GDP-së në tremujorin e dytë të vitit 2020 në krahasim me tremujorin përkatës të vitit 2019, indikojnë për një tkurrje të GDP-së prej 9,3%, ndërkaq në nivel vjetor prej 8%<sup>11</sup>.

Sipas kumtesës përkatëse të ASK-së, tkurrja është reduktuar nga një rritje e vlerës së re në veprimtaritë si prodhimi primar në bujqësi, te furnizimi me energji elektrike, furnizimi me ujë, shërbimet shëndetësore dhe shërbimet e tjera dhe kjo ka reduktuar rënien e përgjithshme të GDP-së, e cila më e shprehura ka qenë në ndërtimtari (45%), transport (48%), hotele dhe restorante (64%). Kjo pasqyrohet në detaje në Tablen – aneks 1. Intervistat me 35 biznese nga sektorë të ndryshëm për kuartalin II të realizuara në korrik vlerësojnë një tkurrje më të madhe thuaja në të gjithë sektorët

sesa që pasqyrohet në kumtesën e ASK-së. Nga ana tjetër, nga intervista e përsëritur me këto 35 biznese e realizuar në tetor, për kuartalin III nuk pasqyrojnë një aktivitet të shtuar ekonomik as gjatë periudhës korrik – shtator 2020 në krahasim me qershorin. (Shih tabelën Aneks 3)<sup>12</sup>. Një indikator tjetër që ilustron rënien e aktivitetit të bizneseve është edhe konsumi i energjisë. Sipas kumtesës së përmendur të ASK-së del se konsumi i energjisë në biznese në periudhën prill –qershor (TM2), ka rënë 13.7% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Ndaj, duket se parashikimi i Bankës Botërore për një tkurrje prej 8,8%<sup>13</sup> në nivel vjetor në krahasim me 2019 –ën është ajo që mund të konsiderohet më reale, nëse jo edhe optimiste. Kjo aq më tepër kur intervistat tona me udhëheqës të bizneseve tregojnë për një rënie të optimizmit, ose më mirë të thuhet gjendja përcillet me një pesimizëm prezent për situatën dhe pritjet e tyre, të ndikuar më së shumti me vonesat në zbatimin e Programit të rimëkëmbjes të paralajmëruar nga Qeveria, i cili edhe pas katër muajve dhe shumë tentimeve mbetet ende për t'u aprovuar, me një pasiguri nëse kjo do të ndodhë shkaku i polarizimit të forcave politike në Kuvend.

Ndërkaq ndikimi më rrënues i COVID-19 ka qenë në aktivitetin investues. Formimi i kapitalit bruto (investimet në asete fikse dhe ndryshimet në inventar nga burime private dhe publike) ka rënë dukshëm (në tremujorin e dytë të vitit 2020, në krahasim me vitin 2019, dhe atë për rreth 43%<sup>14</sup>). Sikur të mos ishte një ritëm i vazhdimtë investimeve publike kjo rënie do të ishte edhe më rrënuese. Investimet

9 MF; Korniza e Shpenzimeve Afatmesme, 2019-2022, Prill 2019

10 Instituti RIINVEST, Intervistat me udhëheqës të bizneseve korrik 2020 dhe tetor 2020

11 Agjencia e Statistikave të Kosovës, Buletini tremuajor, 30 tetor 2020

12 Është për t'u shfrytëzuar fakti se sipas kumtesës së ASK-së, në tremujorin II (mars-maj 2020) ka pasur një rritje të produktit përkatësisht shëtitjeve në industri përpunuese (21%) dhe patundshmëri (3%), e që nga bizneset e këtyre sektorëve del pikërisht e kundërta, kjo sigurisht se do një rishqyrtim dhe analizë përkatëse

13 BB: An Uncertain Rrecovery, Western Balkans Regular Economic Report, fall 2020

14 ASK: Statistikat e llogarive kombëtare, TM2, 2020

private kanë pësuar rënie drastike dhe të shumtën janë ndërprerë fare gjatë tremujorit të dytë. Gjykuar sipas intervistave tona me udhëheqës të investimeve, dhe kjo pak a shumë ka vazhduar edhe me pak përmirësime edhe përgjatë tremujorit të tretë të këtij viti. Ky është një fakt shumë dëshpërues pasi që do përcillet me efekte negative në periudhën e ardhme sa i përket rritjes ekonomike dhe punësimit. Ndonëse të dhënat statistikore zyrtare japin një indikacion për një vëllim përafërsisht të njëjtë të konsumit final të ekonomive shtëpiake gjatë tremujorit të dytë 2020 me atë të vitit paraprak, gjykuar sipas rënies së shitjeve në tregti në tremujorin e tretë edhe këtu duhet pritur një tkurrje<sup>15</sup>. Andaj, rënia e kërkesës agregate do ta mbajë inflacionin në nivele të ulëta e që brenda e gjashtëmujorit ishte rreth 0.6%, ndaj mbi 2 % vitin e kaluar. Ndonëse ASK-ja ka publikuar deri tani anketën e fuqisë punëtore vetëm për tremujorin e parë, e që nuk përfshin efektet e COVID-19, sipas kësaj kumtese norma e papunësisë në tremujorin e parë 2020 ishte 25%, një zvogëlim në krahasim me 26,9 (2019)<sup>16</sup>. Ndonëse shumica e bizneseve private kanë hezitur të bëjnë reduktim të fuqisë punëtore përkundër pandemisë, ajo ka pasur ndikimet negative në produktivitetin e punës. Udhëheqësit e bizneseve kanë deklaruar se po mbajnë formalisht në punë punëtorët edhe përkundër angazhimit të reduktuar, qoftë edhe me paga të reduktuara apo pjesërisht të subvencionuara nga intervenimet qeveritare. Megjithatë, për një pasqyrë më reale duhet pritur të dhënat për periudhat vijuese.

Situata duket më e mirë në sektorin e jashtëm, përkatësisht në këmbimin e mallrave ku kemi një zvogëlim të bilancit negativ tregtar në sektorin e mallrave të ndikuar nga rritja e eksportit (11%), dhe zvogëlim të importit (14%) në periudhën prill-shtator 2020. Rritja e eksportit mund të konsiderohet si një befasi, megjithatë pozitive në këtë situatë. Sipas të dhënave nga ASK-ja, në rritjen e vlerës së eksporteve brenda tremujorit të dytë (TM2) kanë kontribuar më së shumti produktet e industrisë ki-

mike, letër e artikuj prej letre, tekstilet, makineritë e pjesët e tyre, artikuj të ndryshëm të prodhuar. Këtu duhet përmendur edhe eksportin e ndjeshëm të energjisë, i cili brenda kësaj periudhe është rritur 3.7 herë në krahasim me periudhën prill-shtator 2019<sup>17</sup>. Sipas burimit të njëjtë të të dhënave, shumica e sektorëve importues kanë pësuar rënie e veçanërisht produktet e kafshëve dhe produkteve me origjinë shtazore, letër e artikuj letre, tekstilet, ushqimet e pijet, produktet drurit, metalet bazë e artikujt prej tyre, makineri e pajisje, mjete të transportit dhe artikujt e përgjithshëm. Megjithatë, duket se ndikim më të madh ka pasur te rënia e importit të naftës dhe duhanit në sasi dhe vlerë. Në saje të kësaj kemi një rritje të mbulueshmërisë së importit me eksporte të mallrave, e cila tani arrin afro 15%, për dallim nga periudha më herët (10-12 %). Megjithatë, kjo nuk e përmirëson dukshëm deficitin në bilancin tregtar të Kosovës duke marrë parasysh se eksporti i shërbimeve ka pasur një peshë më të madhe në eksportet e Kosovës dhe brenda kësaj periudhe ka pësuar rënie të dukshme, kryesisht për shkak të mungesës së efekteve pozitive të shpenzimeve për mallra dhe shërbime nga kosovarët që janë rezidentë në botën e jashtme (Diaspora), për shkak të reduktimit të tyre të ndjeshëm në Kosovë gjatë verës. Kjo ka bërë që të përkeqësohet dukshëm bilanci tregtar i shërbimeve me jashtë. Derisa në vitin 2019 brenda periudhës janar – gusht Kosova kishte një bilanc pozitiv në këtë fushë prej rreth 790 milionë euro, kjo gjatë vitit 2020, në të njëjtën periudhë është reduktuar në rreth 300 milionë<sup>18</sup>, e që do të thotë se ndikimi negativ i COVID-19 te shpenzimet e Diasporës në Kosovë do të jetë rreth 400-450 milionë euro.

Këto ndikime negative në rënieën kaq të ndjeshme të shitjes së produkteve dhe shërbimeve vizitorëve nga jashtë e Diasporës janë zbutur pjesërisht me trendin pozitiv të dërgesave të emigrantëve përkatësisht remitancave. Kështu në periudhën janar-gusht 2020 remitancat kanë shënuar një rritje domethënëse prej 28.8% (711 milionë euro ndaj

15 Shih tabelën 2, vlerësimet nga intervistat me udhëheqës të bizneseve

16 ASK, Anketa e fuqisë punëtore, TM1 2020

17 ASK, Buletini tremujor, tetor 2020

18 BQK, Buletini mujor statistikor, shtator 2020

552 milionë euro) në krahasim me periudhën përkatëse të vitit 2019<sup>19</sup>. Gjithashtu gjatë periudhës janar –qershor, përtej pritjeve, ka pasur një rritje të investimeve të jashtme direkte (IJD) nga 110 (2019) milionë euro në 164 milionë (2020) euro dhe ato kryesisht kanë pasur të bëjnë me investimet në shërbimet financiare, energji e miniera, duke e kompensuar pak a shumë rënien e madhe të IJD në sektorin e patundshmërisë dhe ndërtimitarisë<sup>20</sup>. Gjithë këto zhvillime kanë ndikuar te një zvogëlim të deficitit të llogarisë rrjedhëse dhe kapitale në bilancin e pagesave nga 294 milionë euro në rreth 228 milionë (23%).

Sistemi financiar dhe ai bankar brenda tij mbetet më pak i ndikuar nga COVID-19, stoku i depozitave dhe kredive ka vazhduar të rritet, ndonëse me dinamikë më të ngadalshme, kurse performanca dhe kthimet në asete e kapital janë relativisht të larta, ndërsa kreditë e këqija mbesin dukshëm më të ulëtat në rajon. Në fund të tremujorit të dytë, në qershor, depozitat arritën 3,9 miliardë, kurse stoku i kredisë 3,1 miliardë, ndaj 3.4 dhe 2,9 respektivisht në vitin 2019. Megjithatë përderisa depozitat mbajnë një dinamikë rritje dyshifrore në baza vjetore, dhënia e kredive të reja në periudhën prill – shtator evidenton një tkurrje prej 10 % në krahasim me një vit më parë. Kjo ishte e evidente sidomos në kuartalin e dytë dhe duket se është tejkaluar në kuartalin e tretë<sup>21</sup>. E gjithë kjo e përcjell me një rënie të lehtë të interesit mesatar në kredi, duke arritur tani normën prej 6.26%, në krahasim me 6.44 një vit më parë. Gjykuar sipas deklaratave të udhëheqësve të bizneseve të intervistuar, përveç mundësisë së shtyrjes së pagesës së kësteve të kredisë, gjatë kuartalit të dytë, nuk ka pasur një angazhim tjetër domethënës nga sektori bankar për të lehtësuar situatën e rënduar me reduktimin e aktivitetit ekonomik. Duke qenë se një shtyrje e pagesës së kredisë ka rritur koston e kredive, shumë nga bizneset nuk kanë

preferuar të shfrytëzojnë këtë mundësi. Ndërkaq ka munguar një angazhim më domethënës në lehtësimin e gjendjes në formë të ristrukturimit ose moratoriumit pa kosto shtesë të kredive. Duke marrë parasysh kapitalizimin shumë të mirë në sektorin financiar dhe të bankave nga njëra anë dhe tkurrjen në sektorët e tjerë të ekonomisë siç u pasqyrua më lart, kjo mundësi do të duhej të shqyrtohej seriozisht. Duket se Banka Qendrore ka instrumente të kufizuara për të ndikuar në koston e kredive, ndonëse te bizneset janë edhe ankesat serioze edhe lidhur me kamatat e larta<sup>22</sup>. Natyrisht se masat administrative nuk janë një opsion, megjithatë kur të kihet parasysh kapitalizimi, ndër më të lartit në rajon dhe BE, te sektori bankar dhe problemet e prezantuara më lart në sektorin real, sidomos atë të bizneseve, nuk mund të konsiderohet një gjendje krejtësisht normale dhe në interes afatgjatë të zhvillimit të të dyja palëve<sup>23</sup>.

Në tërësi këtë konfiguracion vjen edhe rritja e gjendjes së borxhit publik që në fund të shtatorit arrin 1,3 miliard euro ose 19.87% të GDP-së, kundrejt 17,5 % në fund të vitit 2019. Kjo rritje tërësisht i atribuohet rritjes së borxhit të brendshëm (emetimit të bonove të thesarit nga Qeveria) për rreth 143 milionë euro, e që parqet një rritje të kësaj kategorie të borxhit për rreth 18% në krahasim me gjendjen në fund të vitit 2019<sup>24</sup>. Kjo ishte imponuar pak a shumë edhe me rënien e të ardhurave në buxhet dhe nga nevojat për intervenime të parapara me Programin qeveritar të Rimëkëmbjes. Ndonëse niveli i përgjithshëm i borxhit total publik ende mbetet i ultë në raport me GDP-në, në këtë sektor paraqiten një sërë problemesh të ndërlydhura më së shumti me përdorimin efektiv të fondeve nga borxhet, zgjedhja e projekteve në bazë të fizibilitetit dhe normës së kthimit të investimeve raportit cost – benefit dhe tejkalimit të vonesave shumë të mëdha, sidomos të institucioneve publike, në realizimin e projekteve të

19 BQK, Buletini mujor statistikor, gusht dhe shtator 2020

20 BQK, Vlerësimi tremujor i zhvillimeve makroekonomike

21 BQK, Buletini mujor statistikor, shtator 2020

22 Si përgjigje ndaj krizës me COVID -19 gati të gjitha bankat qendrore kanë ulur normat duke intervenuar në tregun monetar, ulur kufizimet sasiore dhe blerë asete (bonot e thesarit ose borxhin publik) për të rritur infuzionin financiar rezervën e obligueshme, shih Dimitris Drakopoulos, Rohit Goel, Fabio Natalucci, and Evan Papageorgiou FMN, tetor 2020.

23 Bankat në Kosovë tregojnë profitabilitet të lartë: Kthimi mesatar në asete 1.8%, kthimi mesatar në kapital 15.5%, kurse kreditë e këqija, jo performuese, janë vetëm 2.6%.

24 Ministria e Financave (Divizioni i Menaxhimit të Borxhit Publik): Quarterly Data on Total Debt

ndërlidhura me borxhin<sup>25</sup>. Qeveria duhet t'i analizojë me kujdes lëvizjet e borxhit publik dhe efektin e përdorimit të tij e sidomos të sigurojë kthimet adekuate nga projektet ku destinohet ai. Ajo që vërehet që tash është rritja dinamike e obligimeve për servisimin e këtij borxhi<sup>26</sup>.

Në kontekstin e ndikimeve potenciale të pandemisë, Banka Botërore tërheq posaçërisht vërejtjen për pasojat e pritshme në rishpërndarjen e të ardhurave në dëm të shtresave të segmenteve të

popullatës më të ardhura më të ulta, me një ndikim në ndërprejen e trendit të zvogëlimit të varfërisë dhe rritjen e saj në vendet e Ballkanit Perëndimor. Në rastin e Kosovës, sipas skenarëve të BB, popullata brenda kufirit të varfërsë do të rritet për 10 % ose për 57,000, ndërsa sipas një skenari më të keq për 148,000 banorë. Së këndejmi, është esenciale që intervenimet qeveritare me transferet sociale të shenjestrojnë popullsinë me të ardhura të ulta , brenda ose afër kufijeve të varfërisë.<sup>27</sup>

---

25 Instituti RIINVEST: Menaxhimi i Borxhit Publik në Kosovë, 2019

26 Shpenzimet e interesit për servisim të borxhit për periudhën janar –shtator kanë regjistruar vlerën prej 21.9 milionë €, duke shënuar rritje vjetore prej 13 % (shih Raporti i performancës së të hyrave janar-shtator).

27 BB: The Economic and Social Impact of Covid -19 ( Western regular Economic Report ) , pranverë 2020.

# 5. PËRGGJIGJET E QEVERISË – INTERVENIMET QEVERTARE

## 5.1. BUXHETI DHE SFIDAT E REALIZIMIT TË TIJ

Me propozimet për rishikimin e buxhetit 2020 dhe analizat përcjellëse makroekonomike që e shoqërojnë atë, bazohet në parashikime më optimiste. Është projektuar një rënie e produktit vendor bruto vetëm për 3%. Rishikimi i buxhetit ka imponuar ndryshime në shumë parametra. Të ardhurat buxhetore janë parashikuar të zvogëlohen për 11,5% (nga 2 miliardë në afro 1,8 miliardë euro), në ndërkohë që shpenzimet e buxhetit janë parashikuar të rriten për 11% (nga 2,3 në 2,6 miliardë euro). Kjo ka ndikuar për rritje të parashikuar të deficitit në bilancin primar të buxhetit nga rreth 337 milionë euro (sa ishte planifikuar me buxhetin e aprovuar në mars 2020), në një deficit primar prej 831 milionë eurosh. Ky deficit synohet të mbulohet nga financimi i jashtëm shtesë prej 321 milionë eurosh (kryesisht me huat e FMN-së, BB-së dhe BE-së) dhe financimin e brendshëm 367 milionë euro (kryesisht emetimi i letrave me vlerë dhe fondet

nga AKP-ja) si dhe zvogëlimi i stokut të bilancit bankar për 143 milionë. E tërë kjo duhet t'i mbulojë kërkesat e paraqitura për financim të Programit të Rimëkëmbjes 385 milionë, rritjes së shpenzimeve kapitale për 63 milionë euro si dhe të subvencioneve e transfereve 18 milionë euro. Me një fjalë ky rishikim i buxhetit i nxitur me situatën rreth COVID-19 kishte për synim t'i rrisë intervenimet qeveritare për këto qëllime për rreth 462 milionë euro. Vlerësimi i ri projektin një rënie të të ardhurave (të hyrave) përkatësisht inkasimeve tatimore dhe rritje të shpenzimeve shtesë të disa kategori dhe kursimet (shkurtime) në disa kategori të tjera. Ndryshimi nga rënia e të ardhurave (nën-inkasimi i projektuar) dhe shpenzimeve shtesë (si ndikimi i masave emergjente) planifikohet të mbulohet nga kursimet (shkurtime) e supozuara, dhe nga financimet shtesë nga financimi i jashtëm (FMN; BE; BB) dhe financimi i brendshëm (Letra me vlerë)<sup>28</sup>.

**TABELA 6. TË ARDHURAT BUXHETORE JANAR –SHTATOR (30.09.2020) (MILION EURO)**

Përshkrimi	Realizuar 2019	Buxheti i rishikuar 2020	Realizuar	% e realizimit të buxhetit	Ndryshimi në % 2020/2019
Të ardhurat e përgjithshme tatimore	1,236.5	1,154.6	1,085.0	-6.0	-12.2
Tatimet direkte (pagat, fitimi, prona)	219.9	212.4	194.6	-8.4	-11.5
TVSH	614.5	574.0	542.3	-5.5	-11.8
Doganat	95.2	76.6	72.2	-5.8	-24.2
Akcizat	322.4	311.8	288.4	-7.5	-10.5
Të ardhurat jotatimore (koncesione, renta, dividenda)	157.3	147.5	135.2	-8.3	-14.0

BURIMI: ADAPTUAR NË BAZË TË MF-SË: RAPORTI I PERFORMANCËS SË TË HYRAVE JANAR-SHTATOR 2020

28 Ministria e Financave: Raporti i performancës së të hyrave janar – shtator 2020

**TABELA 7. SHPENZIMET BUXHETORE JANAR –SHTATOR (30.09.2020) NË MILION EURO**

Përshkrimi	Realizuar 2019	Buxheti i rishikuar 2020	Realizuar 2020	% e realizimit të buxhetit	Ndryshimi në % 2020/2019
Shpenzimet – gjithsej	1,365.1	1,735.3	1,440.7	-17.0	+ 5.5
Pagat e mëditjet	457.3	480.9	490.4	+ 2.0	+7.2
Mallra dhe shërbime	183.4	213.3	178.3	-16.4	- 5.1
Subvencione e transfere	445.6	641.9	545.9	- 15.0	+22.5
Shpenzime kapitale	259.4	337.1	204.3	- 36.4	-21.2
Interesi për borxhin publik	19.4	25.1	21.9	- 12.7	+13.3

BURIMI: ADAPTUAR NË BAZË TË MF-SË: RAPORTI I PERFORMANCËS SË TË HYRAVE JANAR-SHTATOR 2020

Duke marrë parasysh se intervenimet qeveritare afatshkurtra në Kosovë janë të reduktuara kryesisht në instrumentet e politikës fiskale, për të parë ndikimet e COVID-19 dhe përgjigjet ndaj tyre nga ana e Qeverisë, fillimisht mund të pasqyrohen me lëvizjet në të ardhurat dhe shpenzimet buxhetore. Lëvizjet te dy anët e buxhetit pasqyrojnë nga njëra anë reduktimin më të madhe të të ardhurave buxhetore sesa parashikohej me rishikimin e buxhetit për rreth 6% (ose në shumë absolute për rreth 70 milionë euro) e që është më pak sesa në të njëjtën periudhë të vitit 2019 për 12.2% (ose afro 164 milionë euro). Kjo në pjesën më të madhe reflekton situatën që u diskutua më lart, kur turrja ekonomike po del të jetë më e madhe sesa që e parashikoi Qeveria me rastin e rishikimit të buxhetit. Tabelat 6 dhe 7, ilustrjnë lëvizjet e kategorive kryesore të të ardhurave të inkasuara buxhetore dhe shpenzimeve sipas destinimeve kryesore. Ngecja në inkasim, në krahasim me buxhetin e rishikuar sillet prej 5.5 deri në 8.4% dhe ajo është më e theksuar te tatimet në paga, tatimet në të ardhura të korporatave (fitim), tatimi në pronë, tek inkasimi i akcizave dhe të ardhurat nga

renta, koncesionet dhe dividendi, tejkalim të shpenzimeve. Në krahasim me buxhetin e alokuar rritje kishte vetëm te pagat (2%). Llogaria e pagave buxhetore ka dalë të jetë më e madhe sesa rishikimi i buxhetit për rreth 10 milionë, respektivisht për rreth 33 milionë euro në krahasim me vitin 2019. Ngecja edhe më e madhe ishte edhe te shpenzimet në total (-17%), sidomos te shpenzimet kapitale, mallrat e shërbimet dhe subvencionet e transferet. Ndërkaq krahasuar me 2019 shpenzimet kanë një rritje prej 5.5%. Ngecje serioze ka sidomos te shpenzimet kapitale (-36.4%). E gjithë kjo ka deformuar në masë të madhe përpjesëtimet e destinimeve buxhetore duke rritur dukshëm pjesëmarrjen e pagave dhe transfereve dhe subvencioneve sidomos në llogari të shpenzimeve kapitale. Në krahasim me vitin 2019 rritje të shpenzimeve pati vetëm te pagat (7.2%), subvencione e transfere (32.5%) dhe për pagesat e interesit në borxhin publik (+13%). Rritjet e transfereve e subvencioneve ndërlihem me përgjigjet e Qeverisë ndaj situatës së krijuar me COVID-19. Qeveria e Kosovës planifikoi alokimin e shumës prej 365 milionë eurosh, të dedikuara për

29 Përgjatë periudhës janar-shtator 2020, kategoria e pagave dhe mëditjeve kishte pjesëmarrje prej 34.0% në totalin e shpenzimeve, për t'u ndjekur nga shpenzimet e ekzekutuara në emër të subvencioneve dhe transfereve me pjesëmarrje 37.9%; shpenzimet kapitale me pjesëmarrje 11.14.2% mallrat e shërbimet me 12.4%. Sipas raportit të cituar brenda kësaj periudhe, deri në fund të shtatorit, në përgjigje të situatës së krijuar nga pandemia janë disbursuar rreth 142 milionë euro për nevojat emergjente dhe atë 22 milionë nga kategoria e pagave, 10 milionë nga kategoria mallra dhe shërbime, 110.4 milionë euro nga kategoria e transfereve dhe subvencioneve.

përballje me COVID-19 në emër të Programit për Rimëkëmbje Ekonomike, prej të cilave deri në muajin shtator të vitit 2020 u ekzekutuan rreth 143.4 milionë euro<sup>30</sup>. Dhe kjo rritet deri në javën e parë të nëntorit në rreth 207 milionë euro. Është brengosës niveli i ulët i realizimit të shpenzimeve kapitale dhe atë për rreth 36.4 % në krahasim me destinimet e

buxhetit (133 milionë), e të cilat krahas burimeve të planifikuara nga buxheti i rregullt (68.1%) do duhej të mbulohehin edhe nga fondet e likuidimit të AKP-së (12.2%), shpenzimeve për projekte nga huamarrja e jashtme (8.4%); dhe nga fondet vetanake të komunave (10.9%).

## 5.2. PROGRAMI I RIMËKËMBJES DHE PENGESAT LIGJORE

Qeveria aktuale e Kosovës menjëherë pas marrjes së detyrës në fillim të qershorit doli me një Plan të Rimëkëmbjes Ekonomike si përgjigje ndaj pasojave të COVID-19, i cili parashihte një intervenim direkt ose indirekt të Qeverisë në rimëkëmbje prej 1.2 miliard eurosh gjatë vitit 2020 dhe 2021. Realizimi i këtij programi nënkuptonte një ristrukturim të buxhetit, një huamarrje kryesisht prej BB-së dhe FMN-së dhe ndryshimin e disa ligjeve për të mobilizuar mjete të reja ose lehtësuar situatën e bizneseve. Krahas prezantimit të Programit, Qeveria propozoi edhe rishikimin e buxhetit i cili ishte i nevojshëm për shkak të pasojave të COVID-19 në tkurrjen e të ardhurave buxhetore por edhe për një ristrukturim të prioriteteve për t'u përgjigjur ndaj situatës së re.

Ky program ka dy komponentë themelorë - masat urgjente në mbështetje të bizneseve për të penguar daljen e tyre nga tregu dhe rimëkëmbjen ekonomike. Ky dokument është operacionalizuar me aktivitete e bartës të tyre dhe indikacione lidhur me burimet financiare. Programi i rimëkëmbjes përmban këta komponentë, përkatësisht aktivitete e masa:

- Lehtësimi i qasjes në financim
- Zvogëlimi i barrës tatimore
- Mbështetja e punësimit
- Mbështetja e bujqësisë
- Masat për stimulim të kërkesës agregate
- Mbështetja për ndërmarrje publike për operim të rregullt dhe investime kapitale të rëndësishme strategjike

- Rishikimi i buxhetit për 2020 dhe relaksimi i kufizimeve fiskale dhe i borxhit publik
- Masa mbështetëse për ekonomi nga sektori financiar
- Mobilizimi për financimin e masave

Këto fusha përqendruese të intervenimit qeveritar janë zbërthyer pastaj edhe në 32 masa konkrete (shih pasqyrën në Aneks 4). Realizimi këtyre masave deri në fund të tremujorit të tretë (shtator) 2020 ka qenë i limituar me një serë pengesash dhe vonesash. Për aq sa kemi të dhëna efektet ende lënë për të dëshiruar, qoftë për shkak të vonesave qoftë edhe për shkak pengesave ligjore që nuk janë tejkualuar ende në procedurën kuvendore. Kështu ende nuk ka filluar zbatimi i masave që ndërlihen me Ligjin e Rimëkëmbjes e që ka të bëjë me përmirësimin kushteve të kreditimit, lehtësirave tatimore dhe rritjen e kërkesës agregate (mjetet nga kursimet pensionale). Gjithashtu nuk janë vënë në zbatim edhe masat e parashikuara në fushën e subvencionimit të interesave, riprogramimit të kredive ose moratoriumit të tyre pa kosto, masë kjo e ndërlihur me bashkëpunimin me sistemin bankar dhe e theksuar si tepër e nevojshme nga bizneset e intervistuar. Ka pasur një intervenim të subvencionimi i pagave si dhe rritja e subvencionimit për një sërë produktesh bujqësore. Nuk janë ende të prekshme dhe efektive masat për stimulimin e rritjes ekonomike dhe investimeve të paralajmëruara te sektori privat si dhe te ndërmarrjet publike. Në përgjithësi përpjekjet e Qeverisë për

<sup>30</sup> Sipas informacioneve të marra nga Thesari i MF-së, deri në fillim të nëntorit 2020 janë disbursuar gjithsej 207.4 milionë euro, prej të cilave 145.6 për nevojë emergjente të ndihmave dhe mbështetjeve dhe rreth 62 milionë euro për rimëkëmbjen ekonomike.



zbatimin e Programit të Rimëkëmbjes ende bëhen në një situatë të vështirësuar dhe me pengesa e ndikon te vonesat në zbatimin e masave. Nga 365 milionë euro të parapara me rishikimin e buxhetit për nevojat e përballimit të pasojave të COVID-19 dhe rimëkëmbje deri në fillim të nëntorit janë disbursuar 207 milionë, duke përfshi këtu edhe rreth 60 milionë euro subvencione direkte te bizneset private të ndara proporcionalisht në raport me numrin e punëtorëve dhe 1.2 milion euro shtesë për pagat e minatorëve të Trepçës. Programi ka paraparë edhe një sërë masash për nxitje të investimeve në NP dhe përmirësimin të gjendjes së tyre, por kjo ende gjendet në kuadër të shqyrtimit dhe përcaktimit të nevojave nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit<sup>31</sup>.

Ndonëse Programi qeveritar duket mjaft i fokusuar, i strukturuar dhe i qartë në objektivat e tij dhe i arsyeshëm edhe sa i përket vëllimit të paraparë të intervenimit, ai ka nevojë që të rishikohet sidomos në linjën e kërkesave të bizneseve që u prezantuan më lart. Gjithashtu nevojitet një zgjidhje më e mirë midis intervenimeve horizontale në një front të gjerë që nuk krijojnë gjithherë masën kritike për të arritur ndryshimet e synuara dhe intervenimeve më selektive të përqendruara dhe shënjestruara në rastet më të nevojshme në aspektin social dhe intervenimeve në ekonomi që krijojnë një masë kritike për ndikim në rritje ekonomike dhe punësim. Një problem tejet serioz është se këtu nuk shohim ndërlidhjen e domosdoshme midis boshtit shëndetësor dhe atij ekonomik. Nuk ka një indikacion për investime të shpejta në konsolidimin e kapaciteteve të institucioneve shëndetësore në aspektin e kapaciteteve teknike, pajisjeve dhe kapaciteteve humane dhe përmirësimin të kushteve të punës së tyre për të përballuar situata serioze siç është kjo me COVID-19. Kjo si duket është një sfidë shumë serioze dhe që kërkon një nivel tjetër të intervenimeve prej atyre që kemi pasur këto dy dekada.

Përderisa rishikimi i Buxhetit të konsoliduar arriti të aprovet në Kuvend pasi disa tentimesh votimi dhe një vonese të pa arsyeshme, kryesisht të shkaktuar nga krijimi artificial i mungesës së forumit për ta votuar, arriti të aprovet pas një vonese prej afro dy muaj! Të njëjtin fat e kishte edhe ratifikimi i disa marrëveshjeve ndërkombëtare që ndërlidheshin edhe me komponentë të Programit të Rimëkëmbjes. Programi bazohet në një infuzion financiar nga kreditë e donacionet e jashtme prej afro 571 milionë eurosh (shih Aneks 5). Prej këtyre fondeve deri tani janë zotuar rreth 227 milionë euro afro 40% prej tyre<sup>32</sup>.

Programi i Rimëkëmbjes parasheh që përveç këtyre dy komponentëve të mobilizimit të fondeve për Programin e Rimëkëmbjes nevojitet edhe ndryshimi i disa ligjeve. Qeveria zgjodhi që kjo të arrihet nëpërmjet Ligjit për rimëkëmbje ekonomike që targetonte ndryshimin e gjashtë ligjeve që do të kishin një efekt direkt ose indirekt të vlerësuar diku rreth 435 milionë euro<sup>33</sup>. Aprovimi i këtij projekti ligjor assesi të gjejë rrugën. Kanë kaluar më shumë se tre muaj , prej dërgimit të tij në Kuvend, dhe nja 8 tentime të votimit të tij, por asnjëherë nuk u siguroi forumi për të marrë një vendim meritator lidhur me fatin e tij. Situata është përtej absurdit dhe produkt i një lufte politike aty ku më së paku duhet të ketë luftë politike. Te situatat emergjente siç është kjo me COVID-19 krahas cilësisë dhe vëllimit të intervenimit, ka shumë rëndësi edhe koha kur bëhet intervenimi. Efektet e masave varen nëse ato janë bërë në kohën e duhur, pasi në atë rast parandalonjë thellimin e krizës dhe efekteve negative, kurse në situatën si kjo e jona edhe nëse aprovet dhe zbatohen me vonesë do të mundën eventualisht t'i zbusin pasojat shumë negative që kanë mundur të evitohen.

Situata e mobilitetit të Kuvendit për të marrë vendime është tejet serioze dhe është duke e servisuar

31 Nga biseda me ministrin e ekonomisë dhe ambientit dhe zëvendësministrin e financave.

32 BB: An Uncertain Recovery, Western Balkans Regular Economic Report, fall 2020

33 Është fjala për Ligjin për Garanci Kreditore, Ligjin e Fondeve Pensionale, Ligjin për Tatimin në të Ardhura Personale, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike me efekt te fondet e AKP-së, Ligjin për Tatimin në Vlerën e Shtuar, Ligjin për të Ardhurat e Korporatave, Ligjin për Administratën Tatimore.

mbajtjen e një status kuoje që rrezikon vendin në shumë aspekte. Serioziteti i kanosjes së COVID-19 me valën e dytë, vonesat në zbatimin e Programit dhe përgjithësisht situata edhe me pozitën ndërkombëtare të vendit të ndërlidhur me dialogun me Serbinë dhe akuzat e Dhomave të Specializuara të Gjykatës Speciale, në kushtet e një konfiguracioni

të tillë në Kuvend dhe paralizimit të marrjes së vendimeve edhe për shkak të fragjilitetit numerik të Qeverisë dhe veprimit opozitar përtej interesave të vendit dhe stabilitetit të tij kërkojnë urgjentisht që liderët politikë të gjejnë një zgjidhje të përgjegjshme derisa pasojat nuk janë bërë edhe më të rënda dhe të pariparueshme.

# 6. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Efektet e COVID-19 në planin shëndetësor u përkeqësuan dukshëm në fillim të nëntorit, me valën e dytë, pas një situatë më të qetë dhe të menaxhueshme sidomos gjatë periudhës gusht – shtator dhe gjysma e parë e tetorit. Ndonëse me kapacitete të rritura në stafin mjekësor dhe shtim të dukshëm të testeve dhe një mobilizim për ta përballuar gjendjen fluksi i tashëm i frekuencës së infektiveve, nëse vazhdon më gjatë, do të vërë në sprovë serioze sistemin publik shëndetësor. Ndikimet e COVID-19 në rrjedhat ekonomike janë më të rënda sesa që parashikoheshin dhe ato pasqyrohen me përkeqësim të treguesve kryesorë makroekonomikë. GDP-ja do të ketë tkurrje më të madhe sesa që parashikohet rreth 8.8 % (BB) në vend të parashikimeve të Qeverisë për rreth 3%. Të ardhurat e inkasuara buxhetore për 9 muaj po realizohen më pak sesa parashikohet për 6%, ndërsa shpenzimet e parapara për këtë periudhë po ashtu ngecin për rreth 17% për shkak të rënies së dukshme të investimeve publike dhe mosrealizimit të transferëve dhe subvencioneve në mungesë të aprovimit të Ligjit të rimëkëmbjes ekonomike në Kuvend për më shumë se tre muaj. Përtej pritjeve një performancë më të mirë treguan eksportet, investimet e jashtme direkte dhe dërgesat nga emigrantët duke ndikuar në zvogëlimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse në bilancin e pagesave. Sektori financiar tregon një rritje solide të depozitave dhe të aktivitetit kreditor sidomos që nga gushti e këndeje. Megjithatë ky aktivitet nuk duket se lehtëson siç duhet situatën e përballjes me COVID-19 nga bizneset. Mungoi një riprogramim dhe moratorium i kredive pa kosto shtesë që do të kishte një efekt domethënës në lehtësimin e situatës financiare të sektorit privat i bizneseve e sidomos në vazhdimin e aktiviteteve investuese të sektorit privat, i cili po përballlet me thuaja ndërprerje në tremujorin e dytë dhe me një ringjallje fare të vogël në tremujorin e tretë të vitit 2020. Ky është një fakt që do të ketë

shumë efekte negative në periudhën e ardhshme për rritje ekonomike dhe gjenerim të vendeve të reja të punës. Borxhi i përgjithshëm publik vazhdon rritjen dinamike në komponentin e borxhit të brendshëm, duke shtruar po ashtu nevojën e një analize kritike në efektet e përdorimit të tij dhe shkallën e kthimit të investimeve të ndërlidhura me të.

Zbatimi i Programit qeveritar të Rimëkëmbjes Ekonomike mbetet parcial për shkak të vonesës në ndryshimet e legjislatcionit që do të kishin efekt në lehtësimin e barrës tatimore ose përmirësimin në qasjen në financa dhe kushte të kreditës dhe përgjithësisht në rritjen e kërkesës agregate. Gjithashtu nuk shohim një përqendrim për një prioritet të qartë të investimeve në shëndetësinë publike ku shpenzimet qeveritare ngecin shumë jo vetëm në krahasim me standardet evropiane por edhe me vendet e rajonit. Në përgjithësi nevoja e krijimit të parakushteve për zbatim më të suksesshëm të Programit të Rimëkëmbjes mbetet një nevojë kritike.

Situata e mobilitetit të Kuvendit dhe dështimet për të marrë vendime është tejet serioze dhe është duke e servisuar mbajtjen e një status kuoje që rrezikon vendin në shumë aspekte. Serioziteti i kanosjes së COVID-19 me valën e dytë, vonesat në zbatimin e Programit dhe përgjithësisht situata edhe me pozitën ndërkombëtare të vendit, të ndërlidhur me dialogun me Serbinë dhe akuzat e Dhomave të Specializuara të Gjykatës Speciale mbetet shumë serioze. Në kushtet e një konfiguracioni të tillë në Kuvend dhe paralizimit të marrjes së vendimeve edhe për shkak të fragjilitetit numerik të Qeverisë dhe veprimit opozitar, ose mosgatishmërisë së forcave politike në Kuvend për të ndërtuar konsensus bazik në interes të stabilitetit politik, ekonomik e social, përbën një situatë që kërkon urgjentisht që liderët politikë të gjejnë

një zgjidhje të përgjegjshme derisa pasojat nuk janë bërë edhe më të rënda dhe të pariparueshme.

Duke u bazuar në konstatimet dhe gjetjet në këtë Raport, Instituti RIINVEST REKOMANDON sa vijon:

(1) Forcat politike në Kuvend të dakordohen, në mënyrë urgjente, për zhblokimin e funksionimit të Kuvendit dhe marrjes së vendimeve lidhur me çështjet vitale të vendit e në këtë rast edhe për aprovimin e masave buxhetore, ligjore dhe të tjera për të zbatuar Programin e Rimëkëmbjes Ekonomike që do të mundësonte mobilizimin e burimeve financiare, lehtësitë tatimore dhe qasjet në financim;

(2) Qeveria e Kosovës të rrisë efektivitetin e zbatimit dhe të rishikojë Programin e Rimëkëmbjes duke e përshtatur atë me situatën më të re e sidomos të rishqyrtojë qasjen për zbatimin më selektiv të masave që intervenimet e saj:

a. të shënjestrojnë segmentet e shoqërisë në nevojë më të madhe në planin social dhe

b. të sigurohet masë kritike e sasisë dhe cilësisë së intervenimeve në aspektin e ndërtimit të investimeve, rritjes ekonomike dhe punësimit

(3) Qeveria, BQK-ja dhe bankat t'i krijojnë kushtet për një lehtësim të barrës së kredive dhe borxheve të bizneseve nëpërmjet moratoriumit ose riprogramimit pa kosto të kredive përderisa nuk tejkalohet situata me COVID-19

(4) BQK-ja dhe bankat duhet të shohin mundësitë e uljes së nivelit tepër të lartë të mbulimit të kredive me garanci hipotekare

(5) Qeveria dhe Ministria e Shëndetësisë të aprovjnë një plan në mënyrë që gjatë vitit 2020 dhe 2021 të rritet dukshëm kapaciteti i sektorit publik të shëndetësisë në kuptim të infrastrukturës dhe pajisjeve si dhe kapaciteteve humane, duke e rritur shpenzimin qeveritar në shëndetësi nga rreth 3.4% sa është tani në rreth 6%, sa është niveli më i ulët i vendeve në rajon; Në këtë aspekt sugjerohet një rishqyrtim serioz i Kornizës së Shpenzimeve Afatmesme dhe Buxhetit për 2021.

## ANEKSI 1: TE DHENAT MBI PRODUKTIN VENDOR BRUTO NE TREMUJORIN E DYTE

Përshkrimi (në mil. Euro)	2019	2020	INDEX
	TM2	TM2	
Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi	136.4	142.6	1.05
Industria nxjerrëse	41.3	43.7	1.07
Industria përpunuese	220.6	266.4	1.21
Furnizimi me energji elektrike dhe gaz	55.4	69.6	1.26
Furnizimi me ujë	13.7	14.1	1.03
Ndërtimtaria	195.7	107.7	0.55
Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	208.5	188.3	0.90
Transporti dhe magazinimi	76.4	39.6	0.52
Hotelet dhe restorantet	21.1	7.5	0.36
Informimi dhe komunikimi	24.9	33.0	1.32
Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	70.0	65.7	0.94
Afarizmi me pasuri të patundshme	130.3	134.2	1.03
Aktivitetet profesional, shkencore dhe teknike	19.7	19.3	0.98
Aktivitetet administrative dhe mbështetëse	12.9	7.9	0.61
Administrimi publik dhe i mbrojtjes; sigurimi i detyrueshëm social	128.6	140.9	1.10
Edukimi	66.5	62.4	0.94
Shëndetësia dhe aktivitetet e punës sociale	32.4	40.8	1.26
Art, zbavitje dhe rekreacion	7.5	7.8	1.05
Shërbime tjera	3.7	3.9	1.06
<b>Bruto vlera e shtuar, Gjithsej</b>	<b>1,465.41</b>	<b>1,395.46</b>	<b>0.95</b>
<b>Taksat në produkte</b>	<b>324.9</b>	<b>259.2</b>	<b>0.80</b>
<b>GJITHSEJ PVB</b>	<b>1,790.29</b>	<b>1,654.70</b>	<b>0.92</b>

BURIMI: ASK, STATISTIKAT E LLOGARIVE KOMBËTARE, TM2, 2020

## ANEKSI 2: TE DHENAT PER TREGTINE JASHTME – EKSPORTI DHE IMPORTI I MALLRAVE NE TREMUJOIN E DYTE DHE TRETE 2020

Eksporti në ('000) Euro

	2019 PRILL - SHTATOR	2020 PRILL - SHTATOR	INDEX
1.Kafshë të gjalla, produkte me origjinë kafshe	792	546	0.69
2.Produkte bimore	13,334	18.128	1.36
3.Yndyrëra	218	595	2.73
4.Ushqime të përg. pije, pije alkoholike dhe duhan	22,771	22.850	1.00
5.Produkte minerale	22,393	12.612	0.56
6.Produkte të industrisë kimike	3,607	11.432	3.17
7.Plastikë,gomë dhe artikuj prej tyre	26,930	27.793	1.03
8.Lëkurë dhe artikuj prej tyre	3,054	1.444	0.47
9.Druri dhe artikuj druri	3,360	2.654	0.79
10.Letër dhe artikuj prej letëre	2,272	2.630	1.16
11.Tekstil dhe artikuj tekstili	5,557	7.762	1.40
12.Veshëmbathje të këmbëve	1,129	1.188	1.05
13.Artikuj prej guri, allçie, prod. qeramike dhe qelqi	4,559	4.993	1.10
14.Perla, gurë të çmuar, metale të çmuara etj.	3,149	2.020	0.64
15.Metale bazë dhe artikuj prej tyre	79,022	81.300	1.03
16.Makineri, paisje mekanike dhe elektrike	7,023	9.173	1.31
17.Mjetet e transportit	1,802	2.719	1.51
18.Instr.optike,mjeksore,fotog.,muzikore etj.	519	278	0.54
19.Armët dhe municionet		0	
20.Artikuj të ndryshëm të prodhuar	10,234	24.496	2.39
21.Veprat e artit	22.00	146	6.64
<b>TOTALI</b>	<b>211,74</b>	<b>234,759</b>	<b>1.11</b>

Importi në ('000) Euro

	2019 PRILL - SHTATOR	2020 PRILL - SHTATOR	INDEX
1.Kafshë të gjalla, produkte me origjinë kafshe	7,740.5	6,972.4	0.90
2.Produkte bimore	81869	77639	0.95
3.Yndyrëra	15458	13401	0.87
4.Ushqime të përg. pije, pije alkoholike dhe duhan	227961	206732	0.91
5.Produkte minerale	276715	152566	0.55
6.Produkte të industrisë kimike	126610	139595	1.10
7.Plastikë,gomë dhe artikuj prej tyre	118462	113206	0.96
8.Lëkurë dhe artikuj prej tyre	5727	3257	0.57
9.Druri dhe artikuj druri	46373	43627	0.94
10.Letër dhe artikuj prej letër	27869	23291	0.84
11.Tekstil dhe artikuj tekstili	89796	74057	0.82
12.Veshëmbathje të këmbëve	21738	14624	0.67
13.Artikuj prej guri, allçie, prod. qeramike dhe qelqi	67492	60296	0.89
14.Perla, gurë të çmuar, metale të çmuara etj.	1771	2525	1.43
15.Metale bazë dhe artikuj prej tyre	193651	174045	0.90
16.Makineri, pajisje mekanike dhe elektrike	222204	210281	0.95
17.Mjetet e transportit	158854	135923	0.86
18.Instr.optike,mjeksore,fotog.,muzikore etj.	21168	20713	0.98
19.Armët dhe municionet	1655	700	0.42
20.Artikuj të ndryshëm të prodhuar	52596	42114	0.80
21.Veprat e artit	1417	2524	1.78
<b>TOTALI</b>	<b>1,836,791</b>	<b>1,580,840</b>	<b>0.86</b>

BURIMI: ASK: BULETINI TREMUJOR, TETOR 2020

## ANEKSI 3: VLERËRSIMET NGA INTERVISTA E UDHËHEQËSVE TË BIZNESVE PRIVATE MBI ECURINË E SHITJEVE

	SEKTORËT	Mars – Maj	Qershor	Korrik-Shtator
	Bujqësia (prodhimi primar)			
1	Prodhimi i drithërave		+10%	+10%
	Pemët e perimet		-10 deri -20 %	-10 deri -20%
	Industria përpunuese			
	Përpunimi i pemëve e perimeve		-50%	-40%
	Pijet dhe lëngjet	-80%	-10%deri -20%	-20 deri -30 %
	Përpunimi i mishit	-20% deri %	-10% deri -20%	-15 deri -25%
	Përpunimi i qumështit	-20 deri -40%	+20%	- 20 deri -35%
2	Prodhimi i miellit	+20%	+10%	-25 deri -40%
	Përpunimi i drurit	+20%	-20%	-15%
	Përpunimi i metaleve	-80%	-20%	-20%
	Materialet ndërtimore	-30%	-40%	- 30%
	Tekstili	-50%	-50%	-20%
	Plastika	- 80%	-20%	-10%
	Grafika	- 35%	-20% deri -30 %	
4	Ndërtimi		50%	-40%
	Patundshmëritë		-50 deri -70%	Pa ndrysh.
5	Tregtia	+10 deri +30%	-10 % deri -20%	-20 seri -35%
	Akomodimi dhe ushqimi			
6	Hotelet	mbyllur	-95%	-70%
	Restorantet	mbyllur	-60 deri -65%	- 50%
	Kafenetë e vogla	-50%	-50%	-30%
7	Trepça	Pa ndryshime	Rritje e prodhimit	Pa ndryshime
8	KEK-u	Sipas planit	Sipas planit	Pa ndryshime

BURIMI: INTERVISTAT GJYSMË TË STRUKTURUARA ME UDHËHEQËS TE BIZNESEVE, KORRIK DHE TETOR 2020



## ANEKSI 4: PASQYRA E MASAVE NGA PROGRAMI I RIMËKËMBJES DHE REALIZIMI I TYRE

	<b>Përshkrimi masës</b>	<b>Realizimi</b>
1	Rritja e % së garancive përmes Fondit për Garantimin e Kredive	Mungon aprovimi i Ligjit
2	Riprogramimi i kredive bankare me kosto të buxhetit	Pa ndryshime
3	Subvencionimi i normave të interesit për sektorë të caktuar	Pa ndryshime
4	Shtyrje e pagesës së tatimeve bazuar në nevojat e bizneseve	Pjesërisht TM2
5	Mbulimi i 5-përqindëshit të kontributit pensional	Pa ndryshime
6	Pushimet tatimore për firmat për sektorë të caktuar	Pa ndryshime
7	Lirimet për parapagimet e obligimeve tatimore	Mungon aprovimi i Ligjit
8	Lirimi i bizneseve nga ndëshkimet tatimore për vonesa në pagesën e tatimeve për shkak të pandemisë	E realizuar
9	Riprogramim të borxheve tatimore të mëparshme	Pa ndryshime
10	Subvencionim i pagës për punëtorët në biznese	Pjesërisht TM2, TM3
11	Subvencionim i pagës për punësimin e punëtorëve të rinj	Pa ndryshime
12	Përkrahja profesionale për biznese (puna nga shtëpia, puna online)	Pa ndryshime
13	Dyfishimi i buxhetit për Programin për Zhvillim Bujqësor	Vetëm Programi i rregullt, shpallja ne proces
14	Rritje e subvencionimit për hektarë dhe për kokë të bagëtive	E realizuar
15	Mbështetje për shitje të produkteve bujqësore, në veçanti qumështin e freskët, pemët dhe perimet e freskëta	Pa ndryshime
16	Zhvillimi i tregjeve lokale bujqësore dhe digjitalizimi i tyre	Pa ndryshime
17	Mbështetje në përpunimin e produkteve bujqësore dhe deponim	Pjesërisht , shpallja për grante ne proces
18	Subvencionimi i normave të interesit të kredive në bujqësi	Pa ndryshime
19	Kthimi i një përqindjeje të mjeteve të kursyera në Trustin Pensional	Mungon aprovimi i Ligjit
20	Zgjatja e greis periudhës në kredi për blerje të banesave dhe shtëpive	Pa ndryshime
21	Mbulimi i kostove minimale operative të ndërmarrjeve publike	Ne shqyrtim
22	Rishikimi i planit dinamik të investimeve të ndërmarrjeve publike	Ne shqyrtim
23	Mbështetje e investimeve të ndërmarrjeve publike përmes subvencionimit nga buxheti, huadhënies dhe garancive	Ne shqyrtim
24	Identifikimi i hendekut tatimor	Rishikimi i buxhetit
25	Identifikim i kursimeve	Rishikimi i buxhetit
26	Rishpërndarja e shpenzimeve sipas prioriteteve	Rishikimi i buxhetit
27	Pezullimi i rregullës fiskale të deficitit prej 2% për tre vjet	E aprovuar
28	Rritja e kufirit të borxhit publik nga 40% në 50% të PBB-së.	E aprovuar
29	Rishikimi i nivelit të kapitalizimit të nevojshëm për akterët financiarë	Pa ndryshime
30	Rishikimi i rezervës minimale të likuiditetit të detyrueshme	Pa ndryshime
31	Mbështetje për kompanitë e sigurimeve për diversifikim të gamës së shërbimeve siguruese.	Pa ndryshime
32	Mobilizimi i 1.2 miliard eurove për mbështetje ekonomike për 2020 dhe 2021	Pjesërisht

BURIMI: PROGRAMI I RIMËKËMBJES EKONOMIKE – VLERËSIMI I REALIZIMIT NGA AUTORËT

## ANEKSI 5: PASQYRA E MOBILIZIMIT TË BURIMEVE FINANCIARE PËR PROGRAMIN E RIMËKËMBJES

Përshkrimi masës	Realizimi
180 milionë euro kursime nga buxheti i vitit 2020	Zvogëlim i shpenzimeve kapitale dhe mallra e shërbime me rishikim të Buxhetit
51.6 milionë nga FMN-ja	E kontraktuar
100 milionë nga Komisioni Evropian	E kontraktuar
120 milionë nga Banka Botërore	E kontraktuar për 75 milion
60 milionë nga mjetet e privatizimit	Mungon aprovimi i Ligjit të Rimëkëmbjes
100 milionë nga emetimi i letrave me vlerë	E realizua
20 milionë nga emetimi i letrave me vlerë nga diaspora	Pa ndryshime
300 milionë euro kredi ndërkombëtare për financim të projekteve kapitale të ndërmarrjeve publike, komunave dhe të nivelit qendror	Pa ndryshime
100 milionë euro garanci kreditore për projekte investive prodhuese	Mungon aprovimi i Ligjit të Rimëkëmbjes
170 milionë euro kthime të kursimeve pensionale për kontribut-paguesit nga Trusti Pensional.	Mungon aprovimi i Ligjit të Rimëkëmbjes

**BURIMI:** PROGRAMI I RIMËKËMBJES, RAPORTI I BB TETOR 2020, VLERËSIMI I REALIZIMIT NGA AUTORËT

# REFERENCAT

- ASK, Statistikat e llogarive kombëtare, TM2, 2020
- ASK, Anketa e fuqisë punëtore, TM1 2020
- ASK, Buletini tremujor, tetor 2020
- BQK, Buletini mujor statistikor, shtator 2020
- BQK, Buletini mujor statistikor, gusht dhe shtator 2020
- BQK, Vlerësimi tremujor i zhvillimeve makroekonomike
- Bashkëjetesa me COVID-19: Instituti Riinvest (korrik 2020)
- Dimitris Drakopoulos, Rohit Goel, Fabio Natalucci, and Evan Papageorgiou FMN, October 2020:
- European Centre for Disease Prevention and Control (ECDC), 30 tetor 2020
- Korniza e Shpenzimeve Afatmesme 2020-2022, MF, shtator 2020
- Menaxhimi i Borxhit Publik në Kosovë, Instituti Riinvest, 2019
- Ministria e Financave (Divizioni i menaxhimit të borxhit publik): Quarterly Data on Total Debt, shtator 2020
- Ministria e Financave: Raporti i performancës së të hyrave janar – shtator 2020
- Regional Outlook Europe, FMN, tetor 2020
- Un Uncertain Recovery, BB, vjeshtë 2020
- The Economic and Social Impact of COVID-19 (Western Regular Economic Report), BB, pranverë 2020





